

EGP mbështet hapjen e negociatave me Maqedonin e Veriut dhe Shqipërin

Kundër rekomandimeve të vazhdueshme të Komisionit European, Këshilli i Europes refuzoi përsëri hapjen e negociatave me Maqedonin e Veriut dhe Shqipërin. Të dy vendet ishin udhëhequr të besonin se bisedime të tilla do të lejoheshin të fillonin pasi të kishin përmbushur kushtet e kërkuara. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria i kanë përmbushur kushtet e kërkuara, por Këshilli i Europes po thyen fjalën e dhënë nga Europa. Në Deklaratën e Selanikut të vitit 2003, BE e bëri plotësisht të qartë se e shikonte të ardhmen e vendeve të Ballkanit Perëndimorë në antarësimin e tyre në komunitetin Euro-Atlantik dhe, veçanërisht, në BE. Maqedonia e Veriut bëri përpjekje të jashtzakonshme për të hapur derën drejt Europës në marrveshjet e saj dypaleshe me Bullgarin dhe, veçanërisht, marrveshjen historike të Prespes me Greqin. Vendi ndërmori hapa shumë të vështirë dhe në të njëjtën kohë shumë të guximshëm për të kapërcyer ngërçin e disa dekadave. Është një tradhti e tmerrshme që Këshilli European nuk i respekton këto përpjekje.

Në të kaluarën, disa shtete anëtare kanë zvarritur këmbët dhe bllokuar hapjen e negociatave, që ishte sigurisht për të ardhur keq. Por në vendimin e fundit të Këshillit European, ishin vetëm Franca, Danimarka dhe Holanda që bllokuan Shqipërin, dhe ishte vetëm Franca që bllokoi Maqedonin e Veriut. Këto vendime ishin gabime të një dimensionit historik. Ne ju bëjmë thirrje partive tona anëtare në Hollandë, Francë dhe Danimarkë që t'i nxisin qeveritë e tyre të ndalojnë bllokimin e negociatave të pranimit në BE.

European Greens nuk janë të gatshëm ta pranojnë këtë status quo. Ne kemi qënë mbështetës të përpjekjeve të partnerëve tanë në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri për të ecur përpara drejt përfshirjes së tyre në familjen e kombeve europiane dhe, veçanërisht, përpjekjet e anëtarëve tanë, Демократска обнова на Македонија (DOM) në Maqedoninë e Veriut, dhe Partia e Gjëbër në Shqipëri. Ne ritheksojmë vendosmërinë tonë për të kthyer mbarapa veton që mbyllë dyert e integritit për këto dy kombe. European Greens, kërkojnë që përpara Samitit të Zagrebit në maj 2020, Këshilli European jo vetëm që ti kthehet çështjes së zgjerimit, por edhe të kthejë vendimin e tyre të vendosur negativ.

Ne e falenderojmë presidencën e rradhës finlandezë të BE për përpjekjet e saj për të kapërcyer bllokaden, dhe ne i bëjmë thirrje presidencës së ardhshme Kroate të bëjë gjithçka që mundet për ta bërë më në fund BE-në të mbajë premtimin e vet për dy fqinjët tanë në Ballkanin Perëndimorë, Maqedonin e Veriut dhe Shqipërinë.